




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	20/DPK
Dep.	
Dep.	
Nr. i faq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	01-247/15
Br.Prot.	
Prot No.	
Data	
Datum	
Date	30-01-2015
PRISHTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 27.01.2015, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbylllet rasti me Nr. AKK-03-4698-14 për z.Fadil Govori – Dekan në Universitetin “Haxhi Zeka” Pejë, për shkak se është shmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4698-14, për Zyrtarin e lartë, z. Fadil Govori – Dekan në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z.Fadil Govori fillimisht është njoftuar me një shkressë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit (AKK), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtaret e Agjencisë kundër Korruptionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Fadil Govori, është deklaruar se biznesi në fjalë është pasiv, por megjithatë shumë shpejt do t'i bëjë ndryshimet e kërkua e në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, z.Govori, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) “Informata mbi biznesin” (DPK/DPKI-03-131/15) në të cilën shihet se z.Govori tash nuk e ushtron funksionin e personit të autorizuar të biznesit sepse në këtë pozitë e ka zgjedhur një person të besuar, ashtu siç e kërkon ligji për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znej. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znej. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

